

CEL Kosova dhe Departamenti i Psikologjisë

Hartëzimi i shërbimeve psikologjike për personat LGBTQI+



Hulumtuese: Anesa Murseli & Arita Sverka
Mentore: Dr. Kaltrina Kelmendi
Nëntor, 2025

QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETEVE LGBT NË KOSOVË (CEL)

HULUMTUESE: ANESA MURSELI & ARITA SVERKA

MENTORE: DR. KALTRINA KELMENDI

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESË E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga Ambasada e Holandës në Kosovë, Ambasada e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Global Fund for Women, dhe është bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës. Përmbatja e publikimit është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e partnerëve dhe donatorëve.

Abstrakti

Personat e komunitetit LGBTQI+ përballen me sfida të shumta psikologjike që burojnë nga stigmatizimi social, mospranimi, diskriminimi dhe presioni moral dhe kulturor. Në Kosovë, megjithëse ekzistojnë ligje që parandalojnë diskriminimin dhe disa organizata jo qeveritare që ofrojnë shërbime mbështetëse, qasja në kujdesin ndaj shëndetit mendor për komunitetin LGBTQI+ shpesh mbetet e mangët dhe e pabarabartë. Prandaj ky hartëzim i shërbimeve psikologjike për komunitetin LGBTQI+, përmes një qasjeje kualitative eksploruese, ndërthur shqyrtimin e literaturës/dokumenteve (desk review) me intervista gjysmë të strukturuar, të realizuara me pesë pjesëmarrës: tre anëtarë të komunitetit LGBTQI+ dhe dy ofrues të shërbimeve psikologjike që punojnë me këtë komunitet. Procesi i analizimit të të dhënave është zhvilluar në disa faza. Fillimisht, intervistat janë transkriptuar fjalë për fjalë dhe është familjarizuar përmbajtja, pastaj janë identifikuar kodet dhe kategoritë kryesore. Rezultatet tregojnë për pesë të gjetura kyresore ku përfshihet mungesa e mbështetjes institucionale dhe nevoja për më shumë shërbime psikologjike për komunitetin LGBTQI+; roli i rrjeteve sociale dhe sfidat mbi qasjen e shërbimeve psikologjike ekzistente; stigma rreth përdorimit të këtyre shërbimeve dhe ndjenja e mbështetjes nga organizatat joqeveritare. Duke nxjerrë në pah nevojën për krijimin e rrjeteve bashkëpunuese ndërmjet institucioneve publike dhe OJQ-ve, promovimin më të madh për vizibilitet të shërbimeve psikologjike, dhe më shumë trajnime të specializuara për psikologët dhe punonjësit e shëndetit mendor.

Fjalë kyçe: Komuniteti LGBTQI+, hartëzim, shërbime psikologjike, shëndet mendor, Kosovë,

Hyrje

Personat që i përkasin komunitetit LGBTQI+ përballen me rreziqe dukshëm më të larta për probleme të shëndetit mendor krahasuar me popullatën e përgjithshme (Izutsu & Tsutsumi, 2024) (Lampalzer, etj., 2019) (King, etj., 2008). Shumica e studimeve raportojnë nivele të rritura depresioni për të gjitha nën-grupet e minoriteteve seksuale, në të gjitha dimensionet e orientimit seksual (sjellje, tërheqje dhe identitet), për të dy gjinitë, moshat dhe rajonet gjeografike (Plöderl & Tremblay, 2015). Studimet kanë treguar se faktorët e stresit minoritar luajnë një rol të rëndësishëm në këto rezultate. Faktorët përfshijnë forma të hapura të paragjykit, si diskriminimi, mikroagresionet, dhuna dhe homofobia ndërpersonale, ose lidhen me përjetime më personale, si frika nga refuzimi ose internalizimi i paragjykimeve shoqërore ndaj orientimit seksual apo identitetit gjinor (Cruciani, Quintigliano, Mezzalana, Scandurra, & Carone, 2024). Këta stresorë minoritarë – përfshirë stigmën e internalizuar, vetëdijen për stigmën dhe diskriminimin e përjetuar – lidhen ngushtë me rezultate më të dobëta të shëndetit mendor, përmes barrierave të lidhura me stigmën në qasjen ndaj shërbimeve (Crockett, Martínez, & Caviedes, 2022).

Një tjetër studim online me metoda të përziera tregoi se adoleshentët raportojnë një sërë pengesash në qasjen ndaj mbështetjes për shëndetin mendor (Ringle, Sung, Roulston, & Schleider, 2025). Ku çdo pjesëmarrës raportoi të paktën një pengesë, ndërsa mbi 20% raportuan më shumë se një. Analiza përmbajtësore identifikoi 13 kategori të veçanta barrierash, ku më të zakonshmet lidhen me kufizime personale, vështirësi në komunikim me prindërit, dhe shqetësime financiare. Ndër barrierat më të zakonshme për qasjen në shërbimet e shëndetit mendor përfshihen paaftësia për të paguar (62.3%), sigurimi i pamjaftueshëm shëndetësor (52.2%), preferenca për të “pritur” që problemet të kalojnë vetë (51.5%), parehatia në diskutimin e emocioneve (45.7%) dhe ndjenja e turpit apo e sikletit për çështjet e shëndetit mendor (42.5%) (Ferlatte, etj., 2019).

Një numër studimesh të tjera kanë evidentuar se vetë shërbimet e shëndetit mendor shpesh nuk janë të përshtatura për nevojat e komunitetit LGBTQI+. Në shumë raste, profesionistët e shëndetit mendor mbeten të ndikuar nga stereotipe gjinore tradicionale, gjë që çon në diskriminim dhe çasje të kufizuar në kujdes cilësor (Barnett, et al., 2023; Gaur, et al., 2023). Përveç stigmës dhe diskriminimit, studimet e mëparshme kanë treguar se mungesa e trajnimit të specializuar të ofruesve të shërbimit dhe mungesa e mbulimit nga sigurimet shëndetësore janë ndër kontribuesit kryesorë të barrierave në qasjen ndaj shërbimeve për individët LGBTQI+ (Frank-Dixon et al., 2025). Megjithatë, ekzistojnë mundësi për përmirësim përmes trajnimeve psiko-edukative, komunikimit ndërdisiplinar dhe zhvillimit të qasjeve afirmative LGBTQI+. Për shembull, trajtimet online të shëndetit mendor janë treguar efektive për popullatën e përgjithshme dhe mund të përbëjnë një mënyrë efikase për të ofruar kujdes për komunitetin LGBTQI+, duke kapërcyer barrierat gjeografike dhe mungesën e burimeve (Pachankis et al., 2021).

Në këtë drejtim, skanimi mjedisor (environmental scan) është përdorur për të vlerësuar disponueshmërinë e shërbimeve ekzistuese. Një shembull është skanimi i kryer në Ontario, i cili synonte të identifikonte shërbimet për të rinjtë LGBTQ2S+ (lesbian, gay, bisexual, transgender, queer, 2 spirited) dhe mënyrën se si ato ishin përshtatur gjatë pandemisë COVID-19 (Chaiton et al., 2022). Një raport nga SHBA tregoi se vetëm 28% e qendrave për të rinjtë ofronin shërbime të dedikuara për komunitetin në LGBTQI+ vitin 2020 (Choi et al., 2023).

Shërbimet e shëndetit mendor për komunitetin LGBTQI+ në kontekstin e Kosovës

Në Kosovë, shëndeti mendor gjithnjë e më shumë po ngritet si prioritet i rëndësishëm shoqëror, megjithëse sistemi ende përballet me mungesë burimesh, specialistësh dhe qasjeje të barabartë në shërbime psikologjike, edhe pse ekzistojnë ligje që parandalojnë diskriminimin dhe disa organizata qytetare që ofrojnë shërbime mbështetëse, qasja në kujdesin ndaj shëndetit mendor për komunitetin LGBTQI+ shpesh mbetet e mangët (Sopa, 2019). Këto mangësi mund të kenë pasoja të rënda, përfshirë nivele të larta depresioni, ankthi, dhe tentativa vetëvrasjeje. Duke pasur parasysh rëndësinë e mirëqenies psikologjike për të gjithë, ky desk review ka për qëllim të shqyrtojë literaturën dhe dokumentet vendore në Kosovë për të identifikuar disponueshmërinë, barrierat, dhe praktikat që ndikojnë në qasjen në shërbimet psikologjike për personat LGBTQI+. Përmes analizës së revistave lokale, raporteve të organizatave si CEL, dhe burimeve të tjera vendore, ky shqyrtim synon të hartëzojë një panoramë të gjendjes aktuale, të zbulojë boshllëqet dhe të sugjerojë rekomandime për përmirësime të ardhshme.

Në literaturën vendore, një studim i zhvilluar nga Kadriu (2022), me 71 pjesëmarrës të moshës 14–35 vjeç, ka zbuluar se personat LGBTI+ në Kosovë përballen me nivele të larta të shqetësimeve psikologjike, të ndikuara drejtpërdrejt nga përvoja të diskriminimit, abuzimit verbal e fizik, si dhe nga përjashtimi social, ku rezultatet tregojnë se mjedisi konservator dhe mbështetja e kufizuar institucionale kontribuojnë në thellimin e stresit emocional dhe ndjenjës së pasigurisë, veçanërisht tek të rinjtë që nuk gjejnë hapësira të sigurta për shprehjen e identitetit të tyre gjinor apo orientimit seksual. Gjithashtu një raport mbi efektet psikologjike të marginalizimit nga CEL analizon më shumë se 1,200 seanca psikologjike që janë ofruar për 132 persona queer dhe identifikon se ankthi, stresi dhe trauma janë ndër çështjet më të përhapura që përballen këta persona. (Tahiri & Dembogaj, 2025).

Më tepër se aq personat e komunitetit LGBTQI+ në Kosovë përballen edhe me një nivel të lartë të stigmatizimit shoqëror dhe presionit patriarkal, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e tyre psikologjike. Ku stigma e vazhdueshme dhe mungesa e pranimit nga familja, komuniteti dhe shoqëria e gjerë kontribuojnë në izolim, ankth, depresion dhe tentativa vetëvrasjeje (Bami, 2023). Sipas të dhënave të publikuara nga CEL, rreth 38% e pjesëmarrësve nga komuniteti LGBTQI+ kishin tentuar vetëvrasjen, 80% përjetonin ankth të rëndë, 49% depresion të rëndë, dhe 31% nivele të larta stresi (Kadriu, 2022). Këto shifra theksojnë pasojat e drejtpërdrejta të diskriminimit dhe presionit shoqëror në shëndetin mendor të individëve. Për të adresuar këto sfida, organizata CEL ka ofruar programe terapish falas me psikologë të trajnuar për komunitetin LGBTQI+, të cilët ofrojnë mbështetje dhe aftësi për t'u përballur me mjedisin refuzues (CEL, 2025). Njëjtë ofron shërbime psikologjike dhe psiko-sociale për këtë komunitet organizata CSGD (CSGD, 2021). Megjithëse është një pikë e mirë referimi, prapë statistikisht nuk do të mund t'i përgjigjeshin numrit të personave nga komuniteti të cilëve ju nevojiten shërbime psikologjike. Një tjetër organizatë e cila ofron shërbime psikologjike për këtë komunitet, por në formatin e terapisë grupore është organizata Fearless Minds e cila i ofron këto shërbime nga viti 2021 (Fearless Minds Kosovo, 2021). Megjithatë, kapacitetet e ofruara mbeten të kufizuara për shkak të kërkesës së lartë dhe mungesës së mbështetjes institucionale, duke lënë një boshllëk të dukshëm në qasjen sistematike ndaj shërbimeve psikologjike për këtë komunitet (Bami, 2023; Kadriu, 2022). Kjo evidencë nënvizon rëndësinë kritike të adresimit të stigmës dhe zhvillimin e politikave dhe shërbimeve gjithëpërfshirëse që mund të reduktojnë presionin shoqëror dhe të mbështesin shëndetin mendor të personave LGBTQI+ në Kosovë.

Në anën tjetër, përvojat e individëve LGBTQI+ në Kosovë me profesionistët e shëndetit mendor tregojnë sfida të theksuara lidhur me mungesën e ndjeshmërisë dhe të mirëbesimit në trajtimin terapeutik (Halili, 2017).

Një raport i vitit 2016 (CSGD & CEL) tregoi se një person gjatë një seance për të diskutuar identitetin e vet gjinor, psikologu e këshilloi të mos fliste për përvojat e një shoku homoseksual dhe të përqendrohej vetëm te përjetimet e veta personale (Avdiu & Gashi, 2024). Kjo qasje, që synonte të kufizonte diskutimin në përvoja “konkretisht të provuara”, u perceptua si insensitiv dhe pengoi ndërtimin e besimit, duke çuar në braktisje të trajtimit. Për më shumë në të njëjtin raport, të dhënat tregojnë se shumica e profesionistëve janë mbi 40 vjeç, çka sugjeron se ata kanë kryer edukimin shumë më herët dhe mund të mos jenë të njohur me zhvillimet më të fundit lidhur me çështjet e komunitetit LGBTQI+, përfshirë procedurat kirurgjikale për ndërrimin e gjinisë. Dhe pavarësisht që, nga viti 2016, organizata CEL ofron shërbime psikologjike falas për anëtarët e komunitetit LGBTQI+, me qëllimin për t’i përgatitur ata që të përballen me shoqërinë, një tjetër sfidë madhore lidhet me mungesën e psikologëve të përgatitur profesionalisht për të punuar me persona LGBTQI+ (Sopa, 2019). Prandaj mungesa e informimit dhe qëndrimet paragjyquese në sistemin shëndetësor vazhdojnë të jenë pengesë e madhe për qasjen në kujdes cilësor ndaj këtij komuniteti në Kosovë.

Këto gjetje tregojnë se qasja e kufizuar në kujdesin mendor për komunitetin LGBTQI+ është rezultat i një kombinimi i shumë faktorëve socialë, psikologjikë e institucional, prandaj qëllimi i këtij hartëzimi është të ofrojë një pasqyrë mbi shërbimet psikologjike ekzistente për këtë komunitet dhe të analizojë qasjen e tyre në Kosovë, me pyetjet kërkimore:

1: Cilat janë shërbimet psikologjike për personat e komunitetit LGBTQI+ në Kosovë?

2: Çfarë e lehtësojnë apo vështirësojnë qasjen e komunitetit LGBTQI+ në shërbime psikologjike?

Metodologjia

2.1 MOSTRA

Numri i pjesëmarrësve në këtë studim ishte gjithsej pesë. Tre nga pjesëmarrësit tanë ishin pjesëtarë të komunitetit LGBTQI+, dhe dy nga pjesëmarrësit ishin ofrues të shërbimeve psikologjike për komunitetin LGBTQI+. Të gjithë pjesëmarrësit ishin shtetas të Kosovës, si dhe të gjithë ishin mbi moshën 18 vjeç. Mënyra e përzgjedhjes së mostrës ishte e qëllimshme për shkak se synohej të studioheshin përvojat e pjesëtarëve të komunitetit LGBTQI+, dhe të profesionistëve që i ofron shërbimet për këtë komunitet specifik.

2.2 METODA

Ky studim ndjek një qasje kualitative eksploruese, me qëllim të analizimit të gjendjes aktuale të ofrimit të shërbimeve psikologjike për personat LGBTQI+ në Kosovë. Për të siguruar një kuptim gjithëpërfshirës të kontekstit, janë kombinuar tri komponentë metodologjikë: desk review, environmental scan, dhe intervista gjysmë të strukturuar. Kjo qasje lejon analizimin e literaturës ekzistuese, të politikave institucionale dhe të përvojave reale të individëve që i përkasin këtij komuniteti.

2.3 DESK REVIEW

Desk review është përdorur për të vendosur bazën teorike dhe empirike të studimit, e cila e bën të nevojshme analizimin e burimeve të disponueshme përmes dokumenteve ekzistuese dhe raporteve vendore, përfshirë raportet e organizatave joqeveritare, duke ndihmuar në ndërtimin e një pamjeje të përgjithshme të situatës aktuale në vend (Guerin et al., 2019). Kjo metodë është veçanërisht e vlefshme në kontekstin kosovar, ku mungesa e të dhënave të sistematizuara mbi shëndetin mendor dhe komunitetin LGBTQI+ ku kriteret e përzgjedhjes përfshinë, burime të publikuara me fokus në territorin e Kosovës ose në rajonin e Ballkanit Perëndimor, dhe përfshirjen e temave të lidhura me shëndetin mendor dhe qasjen në shërbime për personat LGBTQI+.

2.4 SKANIMI MJEDISOR

Përveç shqyrtimit të literaturës dhe dokumenteve, studimi ka përfshirë edhe një skanim mjedisor, me qëllim të identifikimit të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm që ndikon në ofrimin e shërbimeve psikologjike për komunitetin LGBTQI+ në Kosovë. Në mënyrë të ngjashme, Rowel et al. (2005) e përshkruajnë këtë metodë si një mënyrë për të kuptuar mjedisin praktik të ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe për të identifikuar boshllëqet ndërmjet politikave dhe praktikës.

2.4 PROCEDURA E INTERVISTËS

Intervistat u realizuan në formë gjysmë të strukturuar, duke ndarë pyetjet në dy protokolle të veçanta: një për ofruesit e shërbimeve psikologjike dhe një për pjesëtarët e komunitetit LGBTQI+. Qëllimi i këtyre intervistave ishte të mblidhen të dhëna mbi përvojat e secilës palë lidhur me qasjen dhe barrierat në ofrimin e shërbimeve psikologjike për komunitetin LGBTQI+ në Kosovë. Gjatë këtij procesi, intervistat u realizuan online, me një kohëzgjatje rreth 20 minuta, ku u respektuan parimet etike të anonimitetit, konfidencialitetit dhe vullnetarizmit. Ku intervistat u regjistruan me lejen e pjesëmarrësve dhe u transkriptuan fjalë për fjalë për analizën e mëtejshme tematike.

INTERVISTAT ME OFRUESIT E SHËRBIMEVE: Pyetjet u fokusuan në përvojën profesionale, trajnimet specifike për punën me komunitetin LGBTQI+, ofrimin e shërbimeve ekzistuese, qasjen e klientëve dhe barrierat në ofrimin e ndihmës psikologjike. Gjithashtu, u diskutua roli i institucioneve publike, bashkëpunimi ndërinstitutional dhe nevojat për përmirësim të shërbimeve dhe uljen e stigmatizimit.

Intervistat me pjesëtarët e komunitetit LGBTQI+: Pyetjet u fokusuan në njohurinë dhe vizibilitetin e shërbimeve psikologjike, mënyrat e informimit për to, përvojën personale në kërkimin e ndihmës, pengesat që kanë hasur dhe sugjerimet për përmirësimin e shërbimeve. U kërkua gjithashtu që pjesëmarrësit të përshkruanin preferencat e tyre për organizimin e shërbimeve dhe cilësitë që do të dëshironin tek psikologët që punojnë me komunitetin.

2.5 POZICIONALITETI DHE REFLEKSTIVITETI

A.M. është studente në nivel master në Psikologji Klinike dhe të Komunitetit në Kosovë, e cila ka interes për çështjet sociale dhe psikologjike në kontekstin lokal. Puna e saj është përqendruar kryesisht në kuptimin e dinamikave të stigmatizimit, mirëqenies mendore dhe përfshirjes sociale të grupeve të marginalizuara. A.S. është studente në nivel baçelor në Departamentin e Psikologjisë në Universitetin e Prishtinës, e cila ka përvojë në studimin e çështjeve sociale që prekin gratë, por ka interes edhe mbi çështjet sociale që prekin grupe që diskriminohen siç janë ato queer. Të dy studiueset, zhvilluan hulumtimin në të ngushtë duke kombinuar njohuritë akademike me përvojën hulumtuese në psikologji, gjithmonë në bashkëpunim me mentoren. Dhe është bërë kujdesje maksimale për të minimizuar paragjykimet dhe supozimet personale gjatë intervistave dhe analizës. Dhe gjatë përgatitjes së intervistave, mbledhjes së të dhënave dhe kodimit të rezultateve, është ruajtur neutralitet i plotë ndaj përvojave të pjesëmarrësve që ndihmoi pastaj edhe në vlerësimin kritik të interpretimeve, duke rritur transparencën dhe kredibilitetin e analizës.

3. ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e mbledhura përmes intervistave gjysmë të strukturuar janë analizuar duke përdorur analizën tematike, sipas udhëzimeve të Braun dhe Clarke (2006). Kjo metodë është zgjedhur për fleksibilitetin e saj dhe për aftësinë për të zbuluar modelet e kuptimit brenda përvojave subjektive të pjesëmarrësve. Procesi i analizës është zhvilluar në disa faza. Fillimisht, intervistat janë transkriptuar fjalë për fjalë dhe studiueset janë familjarizuar me përmbajtjen, ku pastaj janë identifikuar njësitë dhe janë krijuar kodat fillestare, të cilat përfaqësonin ide dhe përvoja të përsëritura si: qasja në shërbime, përvoja me stigmatizimin, mungesa e trajnimeve profesionale, dhe roli i institucioneve.

Në fazën e tretë, kodet janë grupuar në kategori më të gjera, duke formuar tema fillestare, të cilat janë rishikuar, përkufizuar dhe emërtuar, duke u fokusuar në qëndrueshmërinë dhe kuptimin e tyre në raport me pyetjet kërkimore. Dhe e tëra është realizuar manualisht

Rezultatet

1. DESK REVIEW

Ky desk review përfshiu dokumente të publikuara nga organizata joqeveritare, lajme të publikuara nga gazeta rajonale, si dhe studime paraprake mbi shëndetin mendor të komunitetit LGBTQI+ dhe shërbimet psikologjike për këtë komunitet. Dokumentimi zbulon burimet e vetme ekzistente në Kosovë sa i përket ofrimit të shërbimeve psikologjike për personat e komunitetit LGBTQI+. Këto shërbime ofrohen në kuadër të organizatave CEL, CSGD, si dhe Fearless Minds (CEL, 2021) (CSGD, 2021) (Fearless Minds, 2021). Të trija këto organizata me bazë në Prishtinë, të cilat ofrojnë shërbime të kësaj natyre që disa vite. Gjithashtu mungesa e dokumentimit të shërbimeve publike për komunitetin LGBTQI+ lë të kuptojë mbi mungesën institucionale shtetërore në ofrimin e këtyre shërbimeve specifike.

Metodologjia

2. SKANIMI MJEDISOR

2.1 SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E SHËRBIMEVE

Në përgjithësi të gjeturat nga skanimi mjedisor tregojnë se shërbimet psikologjike për personat e komunitetit LGBTQI+ janë të përqendruara në Prishtinë. Këto shërbime përfshijnë vetëm ato nga organizatat që operojnë në Prishtinë, megjithëse pranimin e marrësve të shërbimeve psikologjike nuk e kanë të kufizuar në banorët e Prishtinës. Gjithashtu dokumentimi tregon një mungesë të psikologëve klinik të cilët hapur tregojnë se janë afirmues të komunitetit LGBTQI+, përveç psikologëve të cilët ofrojnë shërbimet në kuadër të këtyre organizatave. Dhe kjo shfaq një boshllëk në qasshmërinë që mund të kenë pjesëtarët e komunitetit LGBTQI+ të komunave jashtë Prishtinës në psikologë që ofrojnë shërbime të tilla.

2.2 LLOJI I SHËRBIMEVE DHE MËNYRA E OFRIMIT

Organizata CEL ofron shërbime psikologjike nga psikologët e angazhuar nga organizata, si dhe nga psikiatri i angazhuar nga organizata. Këto shërbime nga CEL ofrohen si seanca psikologjike individuale. Kurse organizata CSGD ofron ndihmë psikologjike për personat e këtij komuniteti, si dhe ndihmë psiko-sociale në rastet kur personat e këtij komuniteti ballafaqohen me situata ku nevojitet udhëheqje procedurale ligjore. Njëjtë edhe organizata Fearless Minds ofron shërbime psikologjike për këtë komunitet veç se në një format pak më ndryshe, në atë të terapisë grupore. Ky shërbim ofrohet me anë të prezencës fizike, apo edhe në mënyrë online.

3. GJETJET NGA INTERVISTAT:

3.1 MUNGESA E MBËSHTETJES INSTITUCIONALE DHE NEVOJA PËR MË SHUMË SHËRBIME

Të dhënat nga intervistat tregojnë se mungesa e mbështetjes institucionale përbën një nga pengesat kryesore në qasjen e komunitetit LGBTQI+ ndaj shërbimeve të shëndetit mendor, dhe duke theksuar që shërbimet psikologjike të specializuara janë të përqendruara kryesisht në Prishtinë, dhe nevojën për shtimin e shërbimeve të tjera.

PRANUESIT E SHËRBIMIT:

“N’qytetin tem jo, e di që s’ka. Kurse për n’Prishtinë e di që ka.” - P.1

‘Institucionet publike nuk e di a kanë naj psikologe dhe a japin shërbime falas’- P.3

‘Po, pa dyshim mendoj që ky shërbim duhet me shku përtej qetyne dy organizatave, sepse është një numër kogja i madh i komuniteteve edhe pse jo edhe qoftë prej shtetit apo edhe klinika tjera me ofru shërbime qoftë falas apo edhe me qenë ma pranues ndaj komunitetit’ -P.2

OFRUESIT E SHËRBIMIT:

“Shërbimet po, domethanë si n’shemicën e fushave tjera domethanë përfshin edhe n’përgjithësi shërbimet e shëndetit mendor për domethanë krejt grupet e tjera sociale, e kanë koncentrimin shumë ma t’madh në Prishtinë. ... se praktikisht qito shërbimet specifike për komunitetin nuk mujnë me vazhdu kushtimisht me thonë me qenë nën mëshirën e organizatave të huaja por duhet me u pa edhe me u shqyrtu modelet tjera të cilat kanë me qenë ma lehtë të zbatueshme n’mënyrë që me e pas një vazhdimësi të ofrimit të shërbimeve specifike për këtë komunitet’- P.4

‘...n’secilin nivel ka vështirësi të tilla kështu që n’aspekt t’nivelit institucional, t’organizatave, edhe të institucioneve private ekziston një lloj bashkëpunimi mirëpo mangësia e kapacitetit nëpër kto e bën vështirësinë mos mu targetu ashtu siç duhet...’ P.5

3.2 ROLI I RRJETEVE SOCIALE SI MJET INFORMUES

Të dhënat e mbledhura tregojnë se rrjetet sociale luajnë një rol thelbësor në informimin dhe qasjen e komunitetit LGBTQI+ ndaj shërbimeve psikologjike. Për shumë pjesëmarrës, platformat e organizatave si CEL dhe rrjeti shoqëror e rekomandimet personale përfaqësojnë burimet kryesore për gjetjen e informacionit mbi psikologët dhe mënyrat e kontaktimit. Këto platforma kontribuojnë në rritjen e dukshmërisë së shërbimeve, në një kontekst ku mungojnë mekanizmat institucional për promovimin e tyre.

PRANUESIT E SHËRBIMEVE:

“...kom hulumtu vet edhe i kom gjetë n’social media.” P.1

“Ka goxha informata edhe n’rrjete sociale, për shembull n’Instagram CEL-i i poston edhe emrat e psikologëve edhe qysh munesh ti me i kontaktu.” P.2

‘...personalisht jam informu prej shoqnisë, prej jetës teme sociale...atëherë kom kërku ndihmë prej një shokut tem, edhe ai shoku më ka tregu edhe më ka informu që ekzistojnë dy lloj OJQ-ja...’ - P.3

OFRUESIT E SHËRBIMEVE:

“Kanë ardhë, po, domethanë qoftë për me anë të ndonjë koleg-, referimi, word of mouth, apo thjeshtë kanë kërku në internet edhe kanë gjetë edhe pastaj po supozoj edhe n’kuadër t’komunitetit domethanë personat të cilët veç se i takojnë, e kanë referencu emrin si dikush që asht i pranushëm” P.4

“Klientët drejtohen kryesisht nëpër kanalet e informimit t’organizatës CEL, faqeve web-faqja dhe rrjetet sociale Facebook, Instagram ku janë kontaktet e renditura aty të gjithë profesionistëve që ofrojmë shërbime dhe nga aty janë kontaktet dhe na kontaktojnë drejt-për-drejt dhe aranzhojmë sesionet psikoterapeutike me ta.” P.5

3.3. SFIDAT MBI QASJEN E SHËRBIMEVE PSIKOLOGJIKE EKZISTENTE

Një ndër sfidat më të përmendura është mungesa e promovimit të mjaftueshëm dhe informimit publik, që bën që shumë individë të mos jenë të vetëdijshëm për ekzistencën e këtyre shërbimeve apo mënyrën e qasjes në to. Siç shprehet një pjesëmarrës:

“Menoj që munet me kon ni promocion pak ma i madh... sidomos nëpër vene ku frekuentohet ma shumë komuniteti duhet me kon pak ma, ni informacion pak ma i gjonë.” P.2

Një tjetër pengesë lidhet me vështirësitë në qasje për shkak të listave të gjata të pritjes, pasi numri i profesionistëve dhe resurseve të disponueshme është i kufizuar:

“...asht pak zor me marrë shërbime psikologjike për shkak se janë falas, duhet ni listë e pritjes, kshtu që t’vyn pak me pritë, kshtu që kisha thanë jo t’qasshme meniherë nashta bash kur ki nevojë.” P.1

‘Po, sepse kur ekzistojnë vetëm dy shërbime, ndonjëherë duhet me prit, se normal që kërkesat janë të mdha...’- P.3

3.4 STIGMA RRETH PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE

Shumë persona hezitojnë të kërkojnë ndihmë nga frika e diskriminimit ose trajtimit jo etik. Gjithashtu pjesëmarrësit shprehen se faktor ndikues mund të jetë edhe dalja haptaz si një psikolog/e që ofron shërbime për komunitetin. Gjë që do të lehtësonte procesin e kërimit të ndihmës nëse pjesëtarët e komunitetit do ndiheshin mjaftueshëm të sigurtë të kontaktojnë një psikolog specifik i cili ofron shërbime për komunitetin.

‘Për shembull, kam rast konkretisht në familje që me bo me i thanë “hej, po m’dokesh pak si keq e mujna me shku te psikologu”, të thotë “pse, a po të dokna i smut a?”, e janë do sende që duhet me kanë pak ma lirshëm’ - P.3
“Munet me kon pak pengesë qikjo që sa osht konfidenciale krejt qikjo....do persona nuk mujnë me kon t’gatshëm ashtu sa me i besu domethonë qaq open tu e marrë parasysh që CEL-i janë koxha open edhe e tregojnë që kanë shërbime për komunitetin ”- P.2

“Jo prej psikologut s’kom pas përvojë t’keqe, po kom pas frikë me shku.....Menoj që asht prapë po tham qikjo, e kena t’internalizume shumë marren, a dish asht marre me shku me fol për ndjenjat e tua te dikush që nuk e njeh, sidomos te ni person tjetër që menojsh që jeton ni jetë heteronormative, edhe asht heteroseksual menojsh që nuk ka me t’kuptu, menojsh që ka me t’paragjyku. Menoj që qikjo o ni pengesë koxha e madhe për komunitetin se nuk kena psikologë që janë haptazi t’dalun që janë pjesë e komunitetit edhe që ofrojnë shërbime për komunitetin specifikisht, e përveq kto t’CEL-it, po une po tham e kam fjalën për psikologë që dalin haptazi kështu”- P.1

OFRUESIT E SHËRBIMEVE:

‘ka ni dozë të konsiderushme të stigmës, fatkeqësisht edhe n’mesin e profesionistëve të shëndetit mendor lidhur me vetë-orientimin apo nëse dikush i takon komunitetit apo jo...po m’doket që ekziston qai farë hezitimi për shkak pjesërisht paragjykit të cili mundet me ekzistë apo qai fakti që dikush munet me pa që o tu përfitu prej ndonjë shërbimi t’shëndetit mendor të ksaj natyre.’ P.4

“ose ofrojnë aktualisht shërbime edhe kanë të ndoshta disa ta themi dallime që bëjnë për ofrim t’shërbimeve specifikisht për komunitet kështu që ish dashtë shumë vetëdijësim do t’thotë n’nivel kombëtar me mbajtë sa ma shumë tryeza, konferenca, me bo hulumtime të tilla çfare keni edhe ju n’mënyrë që me u ngrit vetëdijësimi edhe njëkohësisht me u hap kjo fushë sa ma tepër” P.5

3.5 NDJENJA E MBËSHTETJES DHE ROLI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE

Pjesëmarrësit theksojnë se organizatat joqeveritare kanë luajtur një rol kyç në ofrimin falas dhe të qasshëm të shërbimeve psikologjike, duke raportuar përvoja pozitive në marrëdhënien me profesionistët e shëndetit mendor dhe në mënyrën se si janë pritur në shërbime, të dhëna të cilat janë paraqitur dhe tek tabela 1.0.

PRANUESIT E SHËRBIMEVE:

“M’ka pëlqy që m’ka vyjt mu qaq shpejtë edhe e kom gjetë qaq shpejt si shërbim... jom ni goxha i pranun prej tyne.” P.2
“Aty m’kan prit shumë mirë, nuk m’kan pyet kurgjo që m’ka bo me u ndi keq.” P.1

‘Janë organizata joqeveritare...edhe unë i kom kontaktu me email e me numër edhe normal që i’a kom dal me marrë shërbime edhe falas.’ - P.3

OFRUESIT E SHËRBIMEVE:

“mendojë që momentalisht ofrimet e shërbimeve e kanë natyrën që kanë bo një rritje në kualitet, e rrjedhimisht m’doket që edhe me faktin që personat e komunitetit vazhdojnë me u pranë edhe me kërku shërbime të kësaj natyre gati që detyrimisht domethënë profesionistët do profilizohen, do ta zgjojnë kureshtjen e ndoshta edhe vet iniciativën për me mujt me qenë ma në nivel të detyrës sa i përket kualitetit të shërbimeve që e japin për këtë popullatë”P.4

“mirëpo nëse është në gjendje ku personat kanë tendenca si sucidale na nevojitet patjetër bashkëpunimi me familjen n’këtë rast nëse personi nuk është out në aspektin e komunikimit për atë arsye është një pikë sfiduse mirëpo qysh ndoshta edhe jeni njoftu CEL-i ka edhe psikiatër n’kuadër të shërbimit dhe ne i kordinojmë të gjitha puntë s’bashku me psikiatrin dhe normalisht me klinikën normalisht që me mujt me pas sa ma afër në mbështetje edhe n’observim klientin i cili mundet me pas tendenca të tilla. “ P.5.

KODI	TEMA	CITIME MBËSHTETËSE NGA PJESËMARRËSIT
M.M.I.N.SH	Mungesa e mbështetjes institucionale dhe nevoja për më shumë shërbime	‘...n’secilin nivel ka vështirësi të tilla kshtu që n’aspekt t’nivelit institucional, t’organizatav, edhe të institucioneve private ekziston një lloj bashkëpunimi mirëpo mangësia e kapacitetit nëpër kto e bën vështirësinë mos mu targetu ashtu siç duhet...’ P.5 (ofrues i shërbimeve)
R.RR.S.M.I	Roli i rrjeteve sociale si mjet informues	“Ka goxha informata edhe n’rrjete sociale, për shembull n’Instagram CEL-i i poston edhe emrat e psikologëve edhe qysh munesh ti me i kontaktu.” P.2 (përdorues i shërbimeve)
S.Q.SH.E	Sfidat mbi qasjen e shërbimeve ekzistente	“...asht pak zor me marrë shërbime psikologjike për shkak se janë falas, duhet ni listë e pritjes, kshtu që t’vyn pak me pritë, kshtu që kisha thanë jo t’qasshme meniherë nashta bash kur ki nevojë.” P.1 (përdorues i shërbimeve)
S.P.SH	Stigma rreth përdorimit të shërbimeve	‘ka ni dozë të konsiderushme të stigmës, fatkeqësisht edhe n’mesin e profesionistëve të shëndetit mendor lidhur me vetë-orientimin apo nëse dikush i takon komunitetit apo jo...po m’doket që ekziston qai farë hezitimi për shkak pjesërisht paragjykit të cili mundet me ekzistu apo qai fakti që dikush munet me pa që o tu përfitu prej ndonjë shërbimi t’shëndetit mendor të kësaj natyre.’ P.4 (ofrues i shërbimeve)
N.M.R.O.J	Ndjenja e mbështetjes dhe roli i organizatave joqeveritare	“M’ka pëlqy që m’ka vyjt mu qaq shpejtë edhe e kom gjetë qaq shpejt si shërbim... jom ni goxha i pranun prej tyne.” P.2 (përdorues i shërbimeve)

TABELA 1.0

4. DISKUTIMI

Rezultatet e hulumtimit tregojnë qartë se qasja e komunitetit LGBTQI+ ndaj shërbimeve psikologjike në Kosovë është e ndikuar nga faktorë të shumtë institucionalë, socialë dhe profesionalë. Një nga gjetjet kryesore lidhet me mungesën e mbështetjes institucionale dhe në kontekst të environmental scan tregon një boshllëk në politikat publike për shëndetin mendor, duke nënvizuar nevojën për një rrjet institucional më gjithëpërfshirës dhe të decentralizuar (Ringle et al, 2025).

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që doli nga të dhënat lidhet me rolin e rrjeteve sociale në informimin dhe ndërmjetësimin e qasjes në shërbime. Për pjesëmarrësit, platformat e organizatave si CEL dhe rrjetet shoqërore përfaqësojnë burimet kryesore për gjetjen e informacionit mbi psikologët, oraret dhe mundësitë për mbështetje falas. Kjo tregon se në mungesë të një mekanizmi, rrjetet sociale janë bërë mjeti më efektiv për shpërndarjen e informacionit. Prandaj edhe sfidat më të përmendura nga pjesëmarrësit përfshijnë nevojën për rritje të vizibilitetit të shërbimeve dhe frikën nga diskriminimi gjatë kërimit të ndihmës psikologjike. Por përkundër këtyre sfidave, rezultatet tregojnë gjithashtu përvoja pozitive dhe ndryshime të dukshme në cilësinë e shërbimeve të ofruara nga organizatat joqeveritare.

Në përmbledhje, përfshirja aktive e organizatave joqeveritare tregon një lëvizje drejt ndërtimit të një sistemi më përfshirës dhe më të ndjeshëm ndaj këtij komunitetit. Megjithatë mungesa e mbështetjes institucionale, bashkë me mungesën e promovimit të mjaftueshëm dhe shpërndarjes së barabartë të shërbimeve, vazhdojnë të paraqesin pengesa serioze në qasjen e komunitetit LGBTQI+ ndaj shërbimeve psikologjike (Pachankis et al., 2021). Prandaj ky studim avokon edhe për nevojën për rritje të vizibilitetit dhe qasshmëri më të madhe të shërbimeve në Kosovë. Ky studim shërbeu si një dokumentim i shërbimeve psikologjike ekzistente për komunitetin LGBTQI+ në Kosovë, dhe rezultatet tregojnë se këto shërbime janë të vogla në numër. Gjithashtu studimi shërbeu që të identifikohen boshllëqe në ofrimin dhe qasshmërinë e shërbimeve psikologjike për komunitet, dhe kjo mund të përdoret si një pikë referimi për politikëbërësit dhe profesionistët për të filluar adresimin e këtyre boshllëqeve dhe zhvillimin e strategjive më përfshirëse dhe me bazë komunitare.

KUFIZIMET DHE REKOMANDIMET

Ky studim kishte si mostër tre pjesëtarë të komunitetit LGBTQI+, dhe dy ofrues të shërbimeve psikologjike për pjesëtarët e këtij komunitetit. Duke marrë parasysh që kjo mostër është vështirë të jetë përfaqësuese në numër, rekomandohet që të realizohet ndonjë studim i ardhshëm i cili do të arrinte të shqyrtonte thellësisht të gjitha barrierat potenciale që komuniteti i has gjatë procesit të qasjes dhe marrjes së shërbimit, si dhe rekomandohet të jetë një mostër më e madhe për arsye validiteti të të dhënave të marra.

Një tjetër kufizim është edhe subjektiviteti i përgjigjeve të pjesëtarëve të komunitetit për shkak të natyrës kualitative të mbledhjes së të dhënave, dhe sugjerohet që në të ardhmen metodës së skanimit mjedisor ti bashkëngjitet ndonjë metodë e cila do arrinte të abstrahonte të gjetura Nevoja për trajnime të specializuara për psikologët dhe punonjësit e shëndetit mendor për të punuar me komunitetin LGBTQI+ në mënyrë profesionale dhe të ndjeshme ndaj diversitetit.

Dhe krejt në fund vlen sugjerohet nevoja për trajnime të specializuara për psikologët dhe punonjësit e shëndetit mendor për të punuar me komunitetin LGBTQI+ në mënyrë profesionale, dhe gjithashtu krijimi i rrjeteve bashkëpunuese ndërmjet institucioneve publike, OJQ-ve dhe sektorit privat për të siguruar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri të shërbimeve. Në anën tjetër promovimi më i madh i vizibilitetit të shërbimeve psikologjike, përmes fushatave ndërgjegjëse në media dhe rrjete sociale.

Kurse nga perspektiva për hulumtime e të ardhëshme rekomandohet të eksplorohehen më tej përvojat rajonale të komunitetit LGBTQI+ në qytete të ndryshme të Kosovës, të analizohen qëndrimet dhe përgatitjen profesionale të ofruesve të shërbimeve.

Referencat

- Albright, K. S. (2004). Environmental scanning: Radar for success. *Information Management Journal*, 38(3), 38–45.
- Avdiu, N., & Gashi, N. (2024). Mbrojtja sociale dhe qasja në kujdesin shëndetësor për personat transgjjinorë në Kosovë. CSGD & CEL. https://csgd-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/Transgender-Report_ALB.pdf
- Bami, Xh. (2023). Lufta për pranim: Stigma shoqërore e Kosovës sfiduese ndaj shëndetit mendor të komunitetit LGBTQ. *Balkan Insight*. https://kallxo.com/lajm/lufta-per-pranim-stigma-shoqerore-e-kosoves-sfiduese-ndaj-shendetit-mendor-te-komunitetit-lgbtq/?utm_source=chatgpt.com
- Barnett, M. L., Salem, H., Rosas, Y. G., Feinberg, E., Nunez-Pepen, R., Chu, A., ... Broder-Fingert, S. (2023). Adapting community health worker care models to advance mental health services among LGBTQ youth. *Administration and Policy in Mental Health and Mental Health Services Research*, 50(5), 658–672.
- Braun, V & Clarke, V. (2006). Using thematic analysis in psychology. *Qualitative Research in Psychology*. 3. 77–101. 10.1191/1478088706qp063oa.
- Bowen, G. A. (2009). Document analysis as a qualitative research method. *Qualitative Research Journal*, 9(2), 27–40. <https://doi.org/10.3316/QRJ0902027>
- CEL. (2025, 10 27). CEL Kosova vazhdon me shërbimet psikologjike falas. Retrieved from cel-ks.org: <https://cel-ks.org/cel-kosova-vazhdon-me-sherbimet-psikologjike-falas/>
- CSGD. (n.d.). you-are-heard. Retrieved from you-are-heard.org: <https://csgd-ks.org/service/psychological/>
- Chaiton, M., Billington, R., Copeland, I., Grey, L., & Abramovich, A. (2022). Mental health and addiction services exclusive to LGBTQ2S+ during COVID-19: An environmental scan. *International Journal of Environmental Research and Public Health*, 19(10), 5919. <https://doi.org/10.3390/ijerph19105919>
- Choi, K. R., Wisk, L. E., & Zima, B. T. (2023). Availability of LGBTQ mental health services for US youth, 2014 to 2020. *JAMA Pediatrics*, 177(8), 865–867. <https://doi.org/10.1001/jamapediatrics.2023.1473>
- Crockett, M. A., Martínez, V., & Caviedes, P. (2022). Barriers and Facilitators to Mental Health Help-Seeking and Experiences with Service Use among LGBT+ University Students in Chile. *International Journal of Environmental Research and Public Health (IJERPH)*, 1–16. doi:10.3390/ijerph192416520
- Cruciani, G., Quintigliano, M., Mezzalira, S., Scandurra, C., & Carone, N. (2024). Attitudes and knowledge of mental health practitioners towards LGBTQ+ patients: A mixed-method systematic review. *Clinical Psychology Review*. <https://doi.org/10.1016/j.cpr.2024.102488>
- Fearless Minds Kosovo. (2021). Retrieved from Facebook: https://www.facebook.com/photo.php?fbid=232345762110210&id=100701275274660&set=a.117300350281419&locale=ps_AF
- Ferlatte, O., Salway, T., Rice, S., Oliffe, J. L., Rich, A. J., Knight, R., ... Ogrodniczuk, J. S. (2019). Perceived barriers to mental health services among Canadian sexual and gender minorities with depression and at risk of suicide. *Community Mental Health Journal*, 55(8), 1365–1375. <https://doi.org/10.1007/s10597-019-00445-1>

Frank-Dixon, K., Maneval, M. L., Marais, H., Hochhauser, S., Kraft, E., Herbst, M., ... Lash, B. (2025). Utilization of emergency and outpatient mental health services by LGBTQ populations. *Cureus*, 17(3), e88913. <https://doi.org/10.7759/cureus.88913>

Gaur, P. S., Saha, S., Goel, A., Ovseiko, P., Aggarwal, S., Agarwal, V., ... Gupta, L. (2023). Mental healthcare for young and adolescent LGBTQ+ individuals in the Indian subcontinent. *Frontiers in Psychology*. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2023.1060543>

Graham, I. D., Logan, J., & Harrison, M. B. (2004). Lost in knowledge translation: Time for a map? *Journal of Continuing Education in the Health Professions*, 24(1), 13–24. <https://doi.org/10.1002/chp.47>

Guerin, B., Janta, B., & van Gorp, A. (2018). Desk-based research and literature review. In *Evaluating interventions that prevent or counter violent extremism* (p. 63). RAND Corporation. <https://doi.org/10.7249/RR-2094>

Halili, D. (2017). Fortesa Kadriu: Mos pranimi dhe stigmatizimi në shoqëri e rrezikon shëndetin mendor. Kosovo 2.0. <https://kosovotwopointzero.com/fortesa-kadriu-non-acceptance-stigmatization-society-endangers-mental-health/>

Izutsu, T., & Tsutsumi, A. (2024). Mental Health and Well-Being ofLGBTQI+ Persons. In *Determinants of Loneliness*. doi:<https://doi.org/10.5772/intechopen.1004359>

Kadriu, F. (2022). Stresi i pakicave dhe shëndeti mendor tek të rinjtë lezbike, homoseksuale, biseksuale dhe transgjimore. CEL. https://cel-ks.org/wp-content/uploads/2023/07/Report_Albanian.pdf

King, M., Semlyen, J., Tai, S. S., Killaspy, H., Osborn, D., Popelyuk, D., & Nazareth, I. (2008). A systematic review of mental disorder, suicide, and deliberate self-harm in lesbian, gay and bisexual people. *BMC Psychiatry*, 8(1), 70. <https://doi.org/10.1186/1471-244X-8-70>

Lampalzer, U., Behrendt, P., Dekker, A., Briken, P., & Nieder, T. O. (2019). The Needs of LGBTI People Regarding Health Care. *International Journal of Environmental Research and Public Health*, 105-127. doi:10.3390/ijerph16193547

Pachankis, J. E., Clark, K. A., Jackson, S. D., Pereira, K., & Levine, D. (2021). Current capacity and future implementation of mental health services in U.S. LGBTQ community centers. *Psychiatric Services*, 72(10), 1167–1175. <https://doi.org/10.1176/appi.ps.202000575>

Plöderl, M., & Tremblay, P. (2015). Mental health of sexual minorities: A systematic review. *International Review of Psychiatry*, 27(5), 367–385. <https://doi.org/10.3109/09540261.2015.1083949>

Ringle, V. M., Sung, J., Roulston, C., & Schleider, J. L. (2025). Mixed-methods examination of adolescent-reported barriers to accessing mental health services. *The Journal of Adolescent Health*, 76(2), 268–276. <https://doi.org/10.1016/j.jadohealth.2023.08.034>

Rowel, R., Moore, N. D., Nowrojee, S., Memiah, P., & Bronner, Y. (2005). The utility of the environmental scan for public health practice: Lessons from an urban program to increase cancer screening. *Journal of the National Medical Association*, 97(4), 527–534.

Sopa, S. (2019). Mungojnë psikologët e përgatitur për komunitetin LGBTI. Kosovo 2.0. <https://kosovotwopointzero.com/mungojne-psikologet-e-pergatitur-per-komunitetin-lgbti/>

Tahiri, E., & Dembogaj, M. (2025). Personat queer dhe terapia. CEL. <https://cel-ks.org/wp-content/uploads/2024/12/Personat-queer-dhe-terapia.pdf>

